

ZËRI I POPULLIT RRETH

**'FINALES  
SË MADHE'**

NDËRMJET

**KOSOVËS DHE SERBISË**

VËLLIMI III





Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr.10  
Prishtinë 10000  
Republic of Kosovo  
T/F: +383 38 746 206  
E-mail:[ridea.institute@gmail.com](mailto:ridea.institute@gmail.com)  
W: [www.ridea-ks.org](http://www.ridea-ks.org)

# ***Zëri i Popullit* rreth ‘Finales së Madhe’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë**

## **Vëllimi III**

Mars 2020

# ***Zëri i Popullit* rreth ‘Finales së Madhe’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë Vëllimi III**

**Ky sondazh u mbështet nga:**



Norwegian Embassy

**Deklaratë mohimi:** Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

**Autor:** Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Mars 2020

## Tabela e Përmbajtjes

<b>Përmbledhje Ekzekutive</b> .....	<b>i</b>
<b>1. Hyrje</b> .....	<b>1</b>
<b>2. Metodologjia</b> .....	<b>3</b>
2.1. Dizajni i Sondazhit.....	3
2.2. Procedura e Sondazhit.....	4
2.3. Mostra .....	4
2.4. Karakteristikat e Mostrës .....	6
2.5. Analiza e të dhënave.....	10
<b>3. Gjetjet: Rruga përpara ose prapa</b> .....	<b>10</b>
3.1. Rifillimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë .....	10
3.2. A duhet Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë?.....	12
3.3. <i>Tre skenarët</i> për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë .....	15
3.3.1. Skenari i parë: Vazhdimi i status quo-së .....	16
3.3.2. Skenari i dytë: Njohja de facto nga Serbia, dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës .....	21
3.3.3. Skenari i tretë: Korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës, dhe hapjes së rrugës për anëtarësim në OKB .....	24
<b>4. A mendoni se qeveritë e Kosovës dhe Serbisë duhet të bëjnë përpjekje maksimale për arritje të një marrëveshje përfundimtare?</b> .....	<b>26</b>
<b>5. Struktura e qëndrimeve</b> .....	<b>27</b>
<b>6. Analiza Krahasuese</b> .....	<b>30</b>
<b>7. Përfundimet</b> .....	<b>35</b>

## Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i këtij sondazhi është identifikimi i perceptimeve dhe qëndrimeve të qytetarëve (*Zëri i Popullit*) në lidhje me skenarët rreth 'finales së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ky sondazh është vazhdim i sondazhit të parë dhe të dytë të mbajtur në mes 17-26 dhjetor 2018 dhe 21-28 maj 2019, respektivisht. Puna në terren për sondazhin e tretë u zbatua nga data 20-24 janar 2020. Numri i përgjithshëm i 1107 respondentëve në sondazhin tonë (90% shqiptarë, 8% serbë dhe 2% nga grupe tjera etnike) e përbëjnë mostrën tonë përfaqësuese kombëtare të popullsisë së Kosovës. Një pyetësor paraprak u administrua fillimisht në një pilot grup, me qëllim që të bëhen rregullimet përfundimtare të pyetësorit.

Në këtë studim, për secilën komunë është përdorur *mostra e thjeshtë proporcionale*, bazuar në numrin e popullsisë së komunës. Me një mostër prej 1107, matjet kanë kufirin (marginën) e gabimit prej plus ose minus 3 pikë përqindjeje (në nivel të pesë përqind të rëndësisë statistikore). Sidoqoftë, intervalet e konfidencës për vlerësimet e bazuara në nëngrupet e mostrës, siç është mostra serbe prej 93 të anketuarve, do jenë dukshëm më të mëdha.

Sa i përket rezultateve, në paragrafët e mëposhtëm paraqesim gjetjet për çështjet vijuese:

- i)** rifillimi ose jo-rifillimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
- ii)** në rast të marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, a duhet Kosova të kërkojë të bashkohet me Shqipërinë;
- iii)** perceptimi i qytetarëve të Kosovës lidhur me **tre skenarët** për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; dhe
- iv)** arsyet kryesore për mbështetjen ose mungesën e mbështetjes në lidhje me tre skenarët për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

**Grupi i parë i gjetjeve** tregon se shumica e popullsisë së Kosovës mbështet rifillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në përgjithësi, **70%** e të anketuarve mbështesin rifillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Si shqiptarët ashtu edhe serbët pajtohen që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të rifillojë, edhe pse të anketuarit serbë ishin disi më pak entuziastë se shqiptarët.

**Grupi i dytë i gjetjeve** fokusohet në çështjen nëse Kosova duhet të kërkojë të bashkohet me Shqipërinë, nëse Kosova njihet nga Serbia. Në këtë kontekst, për dallim nga sondazhi paraprak opinioni ka rënë drastikisht, në përgjithësi, **37%** e përkrahin idenë se *Kosova duhet të kërkojë bashkim me Shqipërinë* nëse Kosova njihet nga Serbia dhe **54%** e refuzojnë këtë ide. Shqiptarët kanë shprehur opinion të ngjashëm (edhe pse respondentët serbë kishin më pak mundësi të shprehnin opinion në këtë çështje). Grupi i dytë i gjetjeve gjithashtu u përqendrua në arsyet e mundshme për t'u bashkuar ose jo Kosova me Shqipërinë. Këto janë rezultatet për arsyen se Kosova **duhet të kërkojë** bashkimin me Shqipërinë:

- Të realizojë ëndrrën e disa shqiptarëve për të jetuar brenda një shteti të vetëm (85% e shqiptarëve kundrejt 44% të mostrës serbe);
- Krijon një shtet dhe mjedis më prosperues për të gjithë shqiptarët (87% e shqiptarëve kundrejt 22% të mostrës serbe);
- Stabilizon dhe sjellë paqe në rajonin e Ballkanit përgjithmonë (68% e shqiptarëve kundrejt 22% të mostrës serbe).

Mëposhtë janë rezultatet lidhur me arsyen se pse Kosova **nuk duhet të kërkojë** bashkim me Shqipërinë:

- Është më mirë që Kosova të veprojë si një shtet i veçantë në arenën ndërkombëtare (97% e shqiptarëve kundrejt 16% të mostrës serbe);
- Prosperiteti i Kosovës mund të dëmtohet nga një lëvizje e tillë (75% e shqiptarëve kundrejt 30% të mostrës serbe);
- Nuk do të ishte e drejtë për shqiptarët e tjerë që jetojnë në vende të tjera në rajon (70% e shqiptarëve kundrejt 32% të mostrës serbe).

**Grupi i tretë dhe i fundit i gjetjeve** është i lidhur me perceptimet dhe preferencat e qytetarëve të Kosovës dhe arsytet e mundshme për mbështetjen ose mungesën e mbështetjes për **tre skenarët alternativë** për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Kështuqë, në lidhje me **skenarin e parë-status kuo**-vetëm një numër i vogël i pjesëmarrësve (**12%**) ishin të kënaqur me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sidoqoftë, kishte dallim të madh ndërmjet mostrës shqiptare dhe serbe, ku **90%** në mesin e shqiptarëve dhe **43%** në mesin e serbëve ishin të pakënaqur me status kuo-në aktuale. Arsytet që respondentët janë të **kënaqur me status kuo-në aktuale**:

- Të paktën ka paqe mes Kosovës dhe Serbisë (65% e shqiptarëve kundrejt 49% të mostrës serbe);
- Të paktën pengon dëbimin e serbëve nga Kosova (35% e shqiptarëve kundrejt 37% të mostrës serbe);
- Mban derën e hapur për ruajtjen e ndikimit të fortë serb në disa pjesë të Kosovës (17% e shqiptarëve kundrejt 47% të mostrës serbe);
- Të paktën kemi prosperitet ekonomik (30% e shqiptarëve kundrejt 16% të mostrës serbe);
- Ka marrëdhënie të mira pune me BE-në dhe OKB-në (40% e shqiptarëve kundrejt 12% të mostrës serbe).

Përkundrazi, arsytet që respondentët **nuk janë të kënaqur me status kuo-në aktuale**:

- Kosova nuk mund të ketë lëvizje konkrete drejt integritit evropian (85% e shqiptarëve kundrejt 10% të mostrës serbe);
- Nuk mund të arrijmë njohjen globale të Kosovës (75% e shqiptarëve kundrejt 15% të mostrës serbe);
- Nuk mund të ketë prosperitet ekonomik (62% e shqiptarëve kundrejt 18% të mostrës serbe);
- Kosova nuk mund të ketë marrëdhënie paqësore me Serbinë (57% e shqiptarëve kundrejt 23% të mostrës serbe);

- Kosova nuk mund të zgjidh problemet e brendshme ndërmjet komunitetit serb dhe shqiptar (60% e shqiptarëve kundrejt 50% të mostrës serbe).

Sa i përket *skenarit të dytë -dhënies së kompetencave ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe në Kosovë, në këmbim të njohjes de facto nga Serbia* – vetëm një numër i vogël i respondentëve (15%) tregoi mbështetje për këtë skenarë. Ekziston mbështetje e ulët në mesin e shqiptarëve të Kosovës (11%), por përkrahje e konsiderueshme në mesin e serbëve (53%) për t'i dhënë kompetenca ekzekutive asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Arsyet që respondentët **pajtohen me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe** janë:

- Do të përmirësojë prosperitetin ekonomik në Kosovë (72% e shqiptarëve kundrejt 28% të mostrës serbe);
- Do t'u japë serbëve që jetojnë në Kosovë më shumë zë në procesin e vendimmarrjes (50% e shqiptarëve kundrejt 68% të mostrës serbe);
- Do të përmirësojë integrimin e komunitetit serb në Kosovë (49% e shqiptarëve kundrejt 49% të mostrës serbe);
- Do të përmirësojë marrëdhëniet me Serbinë (47% e shqiptarëve kundrejt 34% të mostrës serbe).

Ndërsa arsyet që respondentët **nuk pajtohen me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe** janë:

- Do të forcojë ndarjet ndërmjet komuniteteve në Kosovë (84% e shqiptarëve kundrejt 38% të mostrës serbe);
- Do të rris tensionet politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (79% e shqiptarëve kundrejt 33% të mostrës serbe);
- Do të hap derën për krijimin e një mini Republika Srpska në Kosovë (86% e shqiptarëve kundrejt 25% të mostrës serbe);
- Do ta bëjë më të vështirë arritjen e prosperitetit ekonomik për Kosovën (55% e shqiptarëve kundrejt 21% të mostrës serbe).



Sa i përket **skenarit të tretë–korigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës dhe hapjes së rrugës për anëtarësim në OKB**, u gjeneruan të dhënat në vijim: **30%** e mostrës totale shprehën mbështetje për këtë skenar, niveli i mbështetjes është rritur në 40% në mesin e mostrës serbe.

Poashtu, kemi ekzaminuar në hollësi strukturën e përgjithshme të qëndrimeve. Gjetjet tregojnë se në thelb janë tre modele kryesore të qëndrimeve. **Modeli i parë** përfshin mbështetjen për status kuo-në, vazhdimin e saj për 5 vitet e ardhshme, rifillimin e dialogut, dhe bërjen e gjitha përpjekjeve për gjetjen e një zgjidhjeje. Repondentët tregojnë tendencë konsistente për këto katër çështje: për shembull, të pakënaqurit me status kuo-në nuk mbështesin vazhdimin e saj për 5 vitet e ardhshme. Ata mendojnë se qeveria duhet të rifilloj dialogun dhe të bëjë çdo përpjekje në gjetjen e një zgjidhjeje. E **dyta** përfshin dhënien e kompetencave ekzekutive për AKS, dhe korigjimin e kufirit me qëllim të arritjes së njohjes globale. Dhe e **treta** përmban vetëm një çështje, bashkimin me Shqipërinë.

Brenda çdo modeli njerëzit tregojnë qëndrime konsistente, por është tregim tjetër sa i përket tregimit **brenda** modeleve: njohuria se ku qëndron njëri në çështje brenda kategorisë së parë nuk është indikator i mirë se ku qëndron në çështje brenda kategorisë së dytë. Pra, njerëzit mund të pajtohen rreth nevojës për rifillim të dialogut dhe se duhet të bëjnë çdo përpjekje për gjetjen e zgjidhjes, por të mos pajtohen rreth marrëveshjes specifike që duhet të bëhet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Për fund, qëndrimet për bashkim me Shqipërinë duket se janë të veçuara nga qëndrimet ndaj të gjitha çështjeve tjera. Bashkimi nuk ndërlihet ngushtë me ndonjë nga çështjet tjera. Thënë ndryshe, njerëzit që mbështesin bashkimin kanë tendencë pothuajse të njëjtë për të qenë të kënaqur apo të pakënaqur me status kuo-në, dhe të mbështesin apo të mos mbështesin korigjimin e kufirit.

Një analizë krahasuese bazuar në tri sondazhet lidhur me *tre skenarët* na mundëson që të kemi përfundime të besueshme. Rezultatet për status kuo-në (**skenari 1**) tregojnë se pakënaqësia me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është rritur nga sondazhi i parë në të dytin, dhe kjo pakënaqësi ka

mbetur shumë lartë në sondazhin e tretë. Rritja e nivelit të pakënaqësisë është vërejtur sidomos në mostrën shqiptare, por ka tendencë të nivelit shumë më të ulët të pakënaqësisë dhe paqëndrueshmërisë më të madhe në mostrat serbe. Ngjashëm, rezultatet e përgjithshme për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe (AKS) në këmbim të njohjes de facto nga Serbia (**skenari 2**) tregojnë se pjesa më e madhe, mbi katër të pestat nga secila mostër vazhdon të mbetet kundër këtij skenari. Mostrat shqiptare tregojnë një nivel të lartë të kundërshtimit për kompetenca të zgjeruara për AKS, ndërsa mostrat serbe kanë pasur rritje të rëndësishme në mbështetje për kompetenca të zgjeruara ekzekutive. Në përgjithësi, rezultatet për korrigjim të kufirit që do të rezultonte në njohje globale të Kosovës dhe hapje të rrugës për anëtarësim në OKB (**skenari 3**) mbeten relativisht stabile edhe pse vërehet një rritje e mbështetjes në mesin e serbëve. Duhet të theksohet se një numër i madh nga mostrat serbe (rreth një e pesta) deklaruan se 'nuk dinë/nuk kanë mendim' për këtë.

Në pika të shkurtra, perspektivat e dy komuniteteve ndryshojnë rrënjësisht në disa aspekte: respondentët serbë treguan shqetësim të veçantë për çështjet e brendshme që prekin komunitetin serbë ndërsa respondentët shqiptarë, në mënyrë të pamohueshme shprehen të shqetësuar për rreziqet e krijimit të një mini Republika Srpska, dhe gjithashtu janë të shqetësuar për çështjet e jashtme sidomos për integrimin në BE dhe njohjen globale.

Si përfundim, *zëri i popullit* të Kosovës është që duhet të ketë ndryshim. Qytetarët nuk dëshirojnë që status kuo-ja të vazhdoj, dhe dëshirojnë që qeveria/institucionet të bëjnë çdo përpjekje në arritjen e një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Sidoqoftë, nuk ka një mesazh të qartë nga qytetarët (qoftë nga komuniteti shqiptar apo serb) se si të arrihet ndryshimi. Megjithatë, në të njëjtën kohë, kjo nuk e përjashton mundësinë e mbështetjes së publikut për një marrëveshje të ndërmjetësuar nga SHBA dhe Evropa. Duke pasur parasysh interesimin/etjen e publikut për përfundim të kësaj rruge qorre dhe sigurimin e njohjes ndërkombëtare dhe integrimin Evropian, një marrëveshje që arrin këto tre qëllime mund të jetë e suksesshme.

## 1. Hyrje

Sondazhi i parë dhe i dytë, *Zëri i Popullit* rreth 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, u realizuan në mes 17-26 dhjetor 2018 dhe 21-28 maj 2019, respektivisht. Pas secilit sondazh, raporte të veçanta janë publikuar dhe gjetjet janë prezantuar nëpërmjet konferencave me disa fokus grupe. Sikur në sondazhin e parë dhe të dytë, sondazhi aktual ka pasur për qëllim të kuptoj perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve në lidhje me skenarët rreth 'finales së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sondazhi aktual i tretë - *Zëri i Popullit* rreth 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Vëllimi III)- është realizuar në mes të datave 20-24 janar 2020. Prandaj, objektivi i sondazhit ishte të kuptoheshin më në thellësi motivet dhe qëndrimet e qytetarëve lidhur me skenarët rreth marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Qëllim tjetër i këtij sondazhi, bazuar në të dhëna të përsëritura ndër-seksionale ishte të kuptoheshin nëse ka ndryshime në lidhje me mbështetjen publike, ose mungesën e mbështetjes, për skenarët e ndryshëm rreth të ashtuquajturës 'finale e madhe'.

Për gati një dekadë dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është lehtësuar nga BE-ja, dhe një numër marrëveshesh janë arritur. Përderisa progres i konsiderueshëm është arritur në aspektin e lirisë së udhëtimit, menaxhimit të kufijve, mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore, dhe integritit të policisë, shumë marrëveshje të tjera nuk janë zbatuar ose janë zbatuar vetëm pjesërisht nga të dy shtetet.<sup>1</sup>

Megjithatë, përkundër progresit dhe disa dështimeve të procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dialogu është ndërprerë që nga nëntori 2018. Kjo për shkak se Qeveria e Kosovës ka vënë një tarifë prej 10% në të gjitha importet e Serbisë dhe Bosnjë Hercegovincës, dhe vendimi fillestar është pasuar me një tarifë

---

<sup>1</sup> Komisioni Evropian (2013) 'Serbia dhe Kosova\*: marrëveshja historike hap rrugën për progres vendimtar në perspektivat e tyre në BE', Deklaratë shtypi, 22 prill. E disponueshme në: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-13-347\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-347_en.htm) (Qasur më: 25/02/2020).

100% për të gjitha mallrat serbe dhe boshnjake.<sup>2</sup> Ky vendim është justifikuar nga Qeveria e Kosovës si përgjigje ndaj Qeverisë serbe për politikën e saj agresive në arenën ndërkombëtare kundër integritit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, siç është INTERPOL. Tarifa ka shkaktuar reagime të gjera nga aktetë vendor dhe ndërkombëtar, duke përfshirë BE-në dhe SHBA-të. Përfaqësues nga BE dhe SHBA kanë kërkuar suspendim të menjëhershëm të tarifës ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnja duke konsideruar se është një masë e nevojshme për rikthim në procesin e dialogut. Qeveria e re e themeluar në Kosovë ka paralajmëruar se tarifa 100% ndaj mallrave nga Serbia do të largohet dhe zëvendësohet me masa të reciprocitetit.<sup>3</sup> Mbetet të shihet nëse ky hap do t'i sjell palët në dialog apo do të vazhdoj t'i mbaj në pozicione armiqësore.

Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve mbetet prioritet në agjendën e BE-së dhe SHBA-së. Kjo u ritheksua në Berlin më 29 prill 2019, në një ngjarje të inicuar dhe organizuar nga Kancelarja Gjermane Angela Merkel dhe Presidenti Francez Emanuel Macron.<sup>4</sup> Edhe pse takimi kishte për qëllim rivendosjen e dialogut, megjithatë dialogu mbetet i bllokuar për shkak të mos-suspendimit të tarifës. Takimi i Berlinit ka prodhuar qëndrime diametralisht të kundërta mbi mënyrën e vazhdimit të dialogut. Debati politik mbi tarifën e vëna dhe mbi skenarët e mundshëm për Marrëveshjen Përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ende vazhdon. Që nga marsi 2019, Gjermania dhe Franca kanë luajtur një rol më aktiv në dialog dhe së fundmi SHBA-ja ka caktuar një të deleguar të veçantë për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.<sup>5</sup>

Pavarësisht zhvillimeve dhe kontekstit aktual të dialogut, duke u bazuar në diskutimet dhe analizat e politik-bërësve të ndryshëm dhe aktetëve relevantë në

---

<sup>2</sup> Radio Evropa e Lirë (2018) 'Kosova rrit taksën doganore për Serbinë dhe Bosnjën në 100 përqind', 21 nëntor. E disponueshme në: <https://www.evropaelire.org/a/rritet-taksa-per-produktet-serbe-/29613129.html> (Qasur më: 05/02/2020).

<sup>3</sup> Guardian (2019) 'BE frikësohet nga fashizmi, deklaroi kryeministri i ardhshëm i Kosovës', 21 tetor. E disponueshme: <https://www.theguardian.com/world/2019/oct/21/kosovo-likely-new-leader-albin-kurti-condemns-eu-balkans-policy> (Qasur më: 06/02/2020).

<sup>4</sup> Ballkani Perëndimor Evropian (2019) 'Gjermania të rifillojë dialogun Kosovë-Serbi me takimin e Berlinit'.

<sup>5</sup> Balkan Insight (2019) 'I dërguari i ri i SHBA-ve gëzon Kosovën, ndërsa Serbinë të habitur', 4 tetor. E disponueshme: <https://balkaninsight.com/2019/10/04/new-us-envoy-delights-kosovo-leaves-serbia-surprised/> (Qasur më: 06/02/2020).

Kosovë dhe Serbi, si dhe në nivelin ndërkombëtar, skenarë të ndryshëm potencial për një Marrëveshje Përfundimtare mund të përvijohen. Këta skenarë për të përmendur vetëm disa përfshijnë: kompetencat ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe, korrigjimin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; 'modelin e dy Gjermanive' dhe kështu me radhë. Në këtë kontekst, raporti aktual hulumtues ka për qëllim të përshkruaj dhe dekonstruktoj shtrirjen e mbështetjes publike në mesin e qytetarëve të Kosovës për skenarë të mundshëm mbi Marrëveshjen Përfundimtare gjithëpërfshirëse ligjërisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ky raport hulumtues përveç çështjeve të tjera ofron një analizë të detajuar të gjetjeve mbi skenarët kryesorë të mundshëm për një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe motivet që i shtyjnë qytetarët drejt, ose larg, çdo skenari të caktuar. Ky raport fokusohet në tre skenarë kryesor të mundshëm: a) vazhdimi i status quo-së; b) njohja de facto nga Serbia, në këmbim të kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës; dhe c) korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës, dhe një rrugë konkrete për anëtarësim në OKB.

Përveç kësaj, raporti hulumtues përshkruan dhe analizon mbështetjen e qytetarëve për rifillimin e dialogut. Përderisa këto janë disa nga çështjet kryesore dhe skenarët e shqyrtuara në këtë raport hulumtues, gjithashtu do të diskutohet edhe një numër i konsiderueshëm i varianteve dhe opsioneve të mundshme.

## **2. Metodologjia**

### **2.1. Dizajni i Sondazhit**

Pyetësi i këtij sondazhi përbëhet nga pyetjet e mbyllura me strukturën vijuese: të dhëna demografike për pjesëmarrësit, perceptimin e tyre, qëndrimin dhe mbështetjen, ose mungesën e mbështetjes për skenarët/opsionet e mundshme për Marrëveshjen Përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Fillimisht,

pyetësoni u administruan në një pilot grup prej 30 të anketuarve për të bërë testimin e kuptueshmërisë nga të anketuarit me qëllim që të bëhen korrigjimet përfundimtare në pyetësor.

## 2.2. Procedura e Sondazhit


Ekipi hulumtues përbëhej nga 14 intervistues në terren (2 për secilin prej 7 rajoneve të Kosovës, plus 2 intervistues special për të anketuarit serbë në Kosovë) dhe 4 hulumtues, eksperti kryesor, dhe 2 ekspertë të lartë (senior) dhe një hulumtues i ri. Puna e tyre rezultoi në raportin aktual të hulumtimit. Intervistuesit në terren i administruan pyetësorët me tabletët elektronik duke përdorur softuerin e dizajnuar posaçërisht për këtë sondazh. Pyetësoni u plotësua nga intervistuesit në terren për të siguruar që nuk kishte mungesë të të dhënave. Megjithatë, të anketuarit ishin të lirë të mos i përgjigjeshin pyetjeve. Për të shmangur njëanshmërinë në intervistë, ekipi hulumtues i trajnoi të gjithë intervistuesit në terren për zbatimin e sondazhit.

Për të kontrolluar punën e intervistuesve gjatë mbledhjes së të dhënave, rreth 41% (gjithsej 450 të anketuar) u ri-intervistuan. Ky kontroll është bërë kryesisht përmes intervistave telefonike dhe ca vizitave në terren. Si kontroll, të anketuarit u pyetën për rreth 5 pyetje bazuar në intervistën origjinale. Lista e kontrollit shërbeu si një mjet për rishikimin e pajtueshmërisë me parimin e përzgjedhjes së rastësishme të të anketuarve (që mbulojnë përzgjedhjen e lokalitetit, pikën fillestare, njësinë e shtëpisë dhe përzgjedhjen e të anketuarit). Përgjigjet e intervistës së parë dhe të dytë u krahasuan. Përveç procesit të zakonshëm të kontrollit, u krye një kontroll logjik i pyetësorëve të plotësuar.

## 2.3. Mostra

Sondazhi u krye në 38 komuna të 7 rajoneve kryesore në Kosovë: Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë (Veri dhe Jug, shih hartën më

poshtë). Kosova ka një popullsi prej 1,798,506 banorë<sup>6</sup>. Në këtë sondazh, për secilën komunë është përdorur mostra e thjeshtë proporcionale, bazuar në madhësinë e popullsisë së komunës, që është në raport me numrin e popullsisë së regjistruar në një komunë specifike me numrin e përgjithshëm të banorëve të regjistruar në Kosovë. Përqindja që rezulton përcakton peshën e secilës komunë në mostër. Baza e popullsisë së regjistruar është nxjerrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.



Pyetësorët u administruan në shtëpitë dhe banesat e të anketuarve. Për të përcaktuar mostrën e studimit është përdorur procedura e mostrës së rastësishme, me rregullat e përcaktuara për zgjedhjen e pikës fillestare, dhe përzgjedhjen pasuese të rrugës, ndërtesës, banesës dhe respondentit. Pyetësi u

<sup>6</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018) "Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2018". E disponueshme në: <http://ask.rks-gov.net/media/4369/statistical-yearbook-2018.pdf> (Qasur më: 06/02/2020).

administrua vetëm tek një anëtar i familjes. Kjo është bërë në këtë mënyrë për të shmangur njëanshmërinë e mostrës.


Për të pasur një mostër mjaftueshëm të madhe të serbëve për analiza më të dobishme, mostra është dyfishuar në dy komunat kryesore serbe, Mitrovicë Veriore (në veri të Kosovës) dhe Graçanicë (në jug të Kosovës). Kjo dha një mostër prej 93 respondentëve serbë në vend të 50 të anketuarve që do të ishin marrë po mos të dyfishonim numrin e mostrës.

#### 2.4. Karakteristikat e Mostrës

Numri i përgjithshëm i të anketuarve në këtë sondazh është 1107. Me një mostër të kësaj madhësie, kufiri i gabimit në vlerësim është plus ose minus 3 pikë përqindje (në nivel të rëndësisë 5 përqind). Vini re që, gabimi i marrjes së mostrave mund të jetë shumë më i madh kur vlerësimet janë vetëm për mostrën serbe prej 93 të anketuarve: me një mostër prej 93, kufiri i gabimit prej 95% do të jetë përafërsisht plus ose minus 10 pikë përqindjeje. Të gjitha dallimet ndërmjet mostrave serbe dhe shqiptare janë kontrolluar për rëndësi statistikore.

Siç është thënë më lart, studimi është kryer në të gjitha (shtatë) rajonet e Kosovës dhe (tridhjetë e tetë) komunat. Shih mëposhtë shpërndarjen e mostrës në shtatë rajonet.





Numri i intervistave për secilën komunë është caktuar në bazë të numrit të popullsisë në secilën komunë dhe shpërndarja e mostrës së arritur kështu korrespondon ngushtë me shpërndarjen e popullsisë. Shih mëposhtë tabelën që përshkruan numrin e popullsisë bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës<sup>7</sup> dhe numrin e intervistave të realizuara nëpër komuna.

**Tabela 1. Madhësia e popullsisë dhe numri i intervistave për komunë**

Nr	Komuna	Popullsia	Nr. i të intervistuarve
1	<i>Ferizaj</i>	<i>103,003</i>	<i>63</i>
2	<i>Shtime</i>	<i>27,654</i>	<i>35</i>
3	<i>Kaçanik</i>	<i>33,409</i>	<i>20</i>
4	<i>Shtërpcë</i>	<i>6,773</i>	<i>8</i>
5	<i>Hani i Elezit</i>	<i>9,998</i>	<i>6</i>
6	<i>Gjakovë</i>	<i>95,340</i>	<i>58</i>
7	<i>Rahovec</i>	<i>59,102</i>	<i>36</i>
8	<i>Deçan</i>	<i>41,808</i>	<i>26</i>
9	<i>Junik</i>	<i>6,370</i>	<i>4</i>
10	<i>Gjilan</i>	<i>80,162</i>	<i>48</i>
11	<i>Kamenica</i>	<i>30,750</i>	<i>19</i>
12	<i>Viti</i>	<i>47,615</i>	<i>29</i>
13	<i>Ranillug</i>	<i>3,810</i>	<i>3</i>
14	<i>Novobërdë</i>	<i>7,160</i>	<i>5</i>
15	<i>Partesh</i>	<i>1730</i>	<i>2</i>

<sup>7</sup>Po aty.


16	<i>Kllokot</i>	<b>2,753</b>	<b>2</b>
17	<i>Mitrovicë</i>	<b>69,346</b>	<b>42</b>
18	<i>Vushtrri</i>	<b>64,468</b>	<b>39</b>
19	<i>Mitrovica Veriore</i>	<b>12,211</b>	<b>40</b>
20	<i>Zveçan</i>	<b>7,376</b>	<b>5</b>
21	<i>Zubin Potok</i>	<b>6,616</b>	<b>5</b>
22	<i>Leposaviq</i>	<b>13,587</b>	<b>10</b>
23	<i>Skenderaj</i>	<b>52,343</b>	<b>32</b>
24	<i>Pejë</i>	<b>99,568</b>	<b>61</b>
25	<i>Istog</i>	<b>40,380</b>	<b>11</b>
26	<i>Klin</i>	<b>40,122</b>	<b>12</b>
27	<i>Prishtinë</i>	<b>211,755</b>	<b>129</b>
28	<i>Obiliq</i>	<b>19,144</b>	<b>12</b>
29	<i>Fushë Kosovë</i>	<b>38,607</b>	<b>24</b>
30	<i>Lipjan</i>	<b>57,733</b>	<b>35</b>
31	<i>Podujevë</i>	<b>83,445</b>	<b>51</b>
32	<i>Glllogoc</i>	<b>61,133</b>	<b>19</b>
33	<i>Graçanicë</i>	<b>12,091</b>	<b>20</b>
34	<i>Prizren</i>	<b>191,565</b>	<b>113</b>
35	<i>Suharekë</i>	<b>60,247</b>	<b>21</b>
36	<i>Malishevë</i>	<b>58,269</b>	<b>37</b>
37	<i>Mamushë</i>	<b>5,950</b>	<b>4</b>
38	<i>Dragash</i>	<b>34,316</b>	<b>21</b>
	<b>Total</b>	<b>1,798,506</b>	<b>1107</b>

90% e mostrës së studimit ishin shqiptarë, 8% serbë dhe 2% ishin nga grupe tjera etnike në Kosovë. Përqindja shqiptare e mostrës korrespondon ngushtë me regjistrimin e vitit 2011, gjë që tregon se 91% ishin shqiptarë, 3.4% serbë dhe 5.6% 'të tjerë'. Proporcioni relativisht i madh serbë në mostër pasqyron dyfishimin e mostrës për popullsinë serbe. (Numri i vogël i grupeve etnike 'të tjera' është shumë i vogël për analiza të dobishme dhe nuk ofron një bazë të besueshme për ta matur/peshuar).

65% e mostrës së studimit janë meshkuj dhe 35% janë femra, mbi-përfaqësim i konsiderueshëm për meshkuj. Në fakt, dallimet gjinore në opinionet e përfshira në këtë raport janë mjaft të vogla. Dallimi kryesor gjinor është se femrat kishin mundësi më shumë për t'u përgjigjur se nuk e ndjekin nga afër politikën. Poashtu,

ato kishin më shumë mundësi se meshkujt të përgjigjen se nuk kanë ndonjë mendim, dhe më shumë janë përgjigjur 'disi pajtohem' në vend të 'fuqimisht pajtohem' krahasuar me meshkujt. Me qëllim të përcaktimit se krahasimeve të besueshme, ne përshtasim mbi-përfaqësimin mashkullor në mostër kur krahasojme rezultatet e tri sondazheve në këtë raport.

Mosha mesatare e mostrës është 40 vjeç dhe mosha ka një shtrirje prej 18-83 vjeç. Mëposhtë është shpërndarja e mostrës sipas grupmoshës.



Sa i përket nivelit të arsimimit, 1% e mostrës ka deklaruar se nuk kanë diplomë shkollore, 4% kanë deklaruar vetëm arsim fillor (1-5 klasë), 9% kanë deklaruar arsim të mesëm të ulët (6-9 klasë), 46% shkollë të mesme të lartë (gjimnaz ose shkollë profesionale), 6% arsim profesional pas shkollës së mesme, 30% kanë deklaruar se kanë diplomë universitare (Bachelor), 5% me Master.

Sa i përket nivelit të punësimit të mostrës sonë, 56% raportuan të jenë punësuar në kohën e intervistës, 22% të papunë, 7% studentë, 7% në pension, 5% që përmbushin detyrat e shtëpisë, dhe disa të papërcaktuar. Lidhur me kategoritë e punësimit, 13% raportuan të jenë në pozita profesionale ose teknike (të tilla si: mjek, mësues, inxhinier, artist, kontabilist, etj.), 4% pozita të larta administrative (të tilla si: bankier, drejtues në biznese të mëdha, zyrtar qeveritar, etj.), 6% pozita

të sekretarisë (të tilla si: sekretar, menaxher i zyrës, mbajtës i librave, etj.), 20% pozita të shitjes (të tilla si: menaxher i shitjes, pronar dyqani, etj.), 7% punëtor të kualifikuar (të tilla si: mekanik i motorit, elektrikist, etj.), 5% punëtor gjysmë të kualifikuar (të tilla si: vozitës autobusi, zdruckhtar, etj.), 3% punëtor të pakualifikuar (të tilla si: punëtor krahu, portier, etj.), 3% punëtor të fermës (të tilla si: fermer, punëtor krahu i fermës, etj.), 13% studentë, 21% amvise, dhe 17% të paspecifikuar.

## 2.5. Analiza e të dhënave

Përgjigjet e pjesëmarrësve u futën në SPSS. Statistikat përshkruese, të tilla si frekuencat dhe kros-tabulimet në bazë të grupeve etnike, janë përdorur për të analizuar të dhënat. Ne gjithashtu kemi kontrolluar nëse rezultatet ndryshojnë sipas moshës, gjinisë, nivelit arsimor dhe gjendjes së punësimit.

## 3. Gjetjet: Rruga përpara ose prapa


Kjo pjesë përshkruan gjetjet e këtij sondazhi në tre nën-kategori: **(i)** rifillimi ose mos-rifillimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; **(ii)** në rast të një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, a duhet Kosova të mbetet e pavarur apo të bashkohet me Shqipërinë; dhe **(iii)** perceptimi i qytetarëve të Kosovës lidhur me *tre skenarët* për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (duke përfshirë arsyet kryesore për mbështetjen apo mungesën e mbështetjes në lidhje me tre skenarët).

### 3.1. Rifillimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë


Në lidhje me këtë çështje, është parashtruar pyetja si në vijim: **A pajtoheni me rifillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?**

Gjetjet në lidhje me këtë çështje vijojnë: Rreth 27% deklaruan se 'aspak' ose 'shumë pak' pajtohen me rifillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Rreth

70% e mostrës deklaruan që 'disi' ose 'shumë' pajtohen me rifillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Afërsisht, 4% në mesin e pjesëmarrësve deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje. Prandaj, ekziston një ekuilibër i qartë në favor të rifillimit të dialogut.



Vlerësimi i përgjigjeve për mostrat shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ngjashëm të përgjigjeve: 27% në mesin e shqiptarëve dhe rreth 30% në mesin e serbëve shprehen se pajtohen 'shumë pak' ose 'aspak' me rifillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 70% në mesin e shqiptarëve dhe 66% në mesin e serbëve shprehen se pajtohen 'disi' ose 'shumë' me rifillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sidoqoftë, siç mund të shihet, respondentët serbë kanë zgjedhur më shumë kategoritë e ndërmjetme 'disi' ose 'shumë pak' më shumë se kategoritë më kategori ekstreme si 'shumë' ose 'aspak' (dallimet janë statistikiisht të rëndësishme në pikën 0.01). Me fjalë të tjera, respondentët serbë ishin më pak të entuziazmuar se respondentët shqiptarë për rifillim të dialogut. 3.5% në mesin e shqiptarëve dhe 4% në mesin e serbëve deklarohen se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




### 3.2. A duhet Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë?


Sa i përket pyetjes nëse Kosova duhet të bashkohet me Shqipërinë, sondazhi ka paraqitur pyetjen e mëposhtme:

**Nëse Kosova do të njihet nga Serbia, a duhet Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë?**

37% e mostrës totale u përgjigj me Kosova 'duhet patjetër' ose 'ndoshta duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia. 54% u deklaruan që Kosova 'definitivisht nuk duhet' ose 'ndoshta nuk duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia. 9% në mesin e pjesëmarrësve u deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




Vlerësimi i përgjigjeve për mostrat shqiptare dhe serbe tregon një model të kundërt (dhe shumë të ndryshëm) të përgjigjeve: 40% në mesin e shqiptarëve dhe 10% në mesin e serbëve shprehen se Kosova 'definitivisht duhet' ose 'ndoshta duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia. 55% në mesin e shqiptarëve dhe 47% në mesin e serbëve shprehen se Kosova 'ndoshta nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia (shih grafikun më poshtë). 5% në mesin e shqiptarëve dhe 43% në mesin e serbëve deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Në një seri pyetjesh pasuese, sondazhi kërkon të kuptojë arsyet kryesore e të anketuarve se pse Kosova duhet ose nuk duhet të kërkojë bashkim me Shqipërinë.


Mëposhtë, ne tregojmë dallimet midis shqiptarëve dhe serbëve lidhur me arsyet kryesore që Kosova duhet të kërkojë bashkim me Shqipërinë. Këto pyetje iu janë parashtruar vetëm të anketuarve të cilët u përgjigjën se Kosova 'definitivisht duhet' ose 'ndoshta duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia (40% shqiptarë dhe 10% serbë u janë përgjigjur pozitivisht bashkimit):



Siç mund të shihet, nga të anketuarit që ishin në favor të bashkimit, shqiptarët kishin pikëpamje pozitive të përfitimeve ekonomike, politike dhe aspiruese të bashkimit, ndërsa të anketuarit serb ishin dukshëm më pak pozitiv për këto tri arsye.

Në kontekst të arsyeve për mos kërkimin e bashkimit, të anketuarit të cilët ishin përgjigjur se Kosova 'definitivisht nuk duhet' ose 'ndoshta nuk duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë u pyetën një seri pyetjesh të ndryshme pasuese (mbani mend 55% e shqiptarëve dhe 47% e serbëve nuk dëshironin të kërkonin bashkim dhe kështu u pyetën këto pyetje të veçanta pasuese):





Këtu mund të shohim se respondentët shqiptarë që ishin kundër bashkimit ishin veçanërisht të prirur për të arsyetuar me përparësinë ndërkombëtare për të pasur dy shtete, dhe ishin shumë më pak të prirur për të theksuar përfitimet ekonomike. Në anën tjetër, respondentët serbë theksonin më shumë argumentin se bashkimi do ta destabilizonte rajonin.


### 3.3. Tre skenarët për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Pjesëmarrësit e sondazhit u njoftuan me opsionet/alternativat vijuese për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: a) vazhdimi i status kuo-së; b) njohja de facto nga Serbia, në këmbim të kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës; dhe c) korigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës, dhe hapjes së rrugës për anëtarësim në OKB. Për sqarim, intervistuesit u shpjeguan respondentëve, dhe gjithashtu ishte e sqaruar në pyetësor, se çfarë

nënkuptohet me status kuo<sup>8</sup>, njohje de facto dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive<sup>9</sup>.

### 3.3.1. Skenari i parë: Vazhdimi i status kuo-së

Sa i përket skenarit të parë, të anketuarve iu është parashtruar pyetja në vijim: Sa jeni të kënaqur me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë? 12% e mostrës totale u përgjigjen me 'shumë i kënaqur' ose 'disi i kënaqur' rreth status kuo-së aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shih grafikun mëposhtë). Tri të katërtat e pjesëmarrësve (75%) u deklaruan 'aspak i kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe 10% tjerë deklaruan 'shumë pak të kënaqur'. 3% u deklaruan me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




Sidoqoftë, një analizë e veçantë e mostrës shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ndryshëm të përgjigjeve nga dy komunitetet. 8% në mesin e mostrës shqiptare dhe 46% në mesin e serbëve u shprehën me 'shumë i kënaqur' ose 'disi i kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 90% në mesin e shqiptarëve krahasuar me 43% në mesin e serbëve janë 'shumë pak të kënaqur'


<sup>8</sup> Me status kuo, nënkuptohet mungesa e njohjes reciproke dhe marrëdhëniet politike dhe diplomatike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë të pezulluara.

<sup>9</sup> Me njohje de facto, nënkuptohet që Serbia i njeh institucionet e Kosovës por nuk do ta njohë shtetësinë e Kosovës; me kompetenca të zgjeruara ekzekutive, nënkuptohen fuqitë që do të përfshijnë ndryshimet kushtetuese në Kosovë dhe do të krijojnë entitet të ri politik në Kosovë, që do të ishte një njësi gjysmë autonome.

ose 'aspak të kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shih grafikun mëposhtë). 2% në mesin e shqiptarëve dhe 11% në mesin e serbëve u përgjigjen me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. [Kjo është konsistente me gjetjet e raportuara më lartë se mostra serbe është më pak entuziaste për rifillimin e dialogut.]




Pastaj, ne vazhduam me një numër pyetjesh pasuese për arsyet kryesore se pse të anketuarit ishin apo nuk ishin të kënaqur me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Të anketuarit që u përgjigjen me 'shumë i kënaqur' ose 'disi i kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, u shprehen si në vijim (shih grafikun mëposhtë) në lidhje me arsyet kryesore se pse ata ishin të kënaqur me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (mbani në mend se vetëm 8% e mostrës shqiptare krahasuar me 46% e mostrës serbe ishin të kënaqur dhe kështu iu janë parashtruar këto pyetje pasuese, prandaj përgjigjet e respondentëve shqiptarë bazohen në një numër shumë të vogël):




Siç mund të shihet, si respondentët shqiptarë ashtu dhe serbë, 'të paktën ka paqe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë' ishte arsyeja më e shpeshtë për mbështetjen e status kuo-së. Përkundrazi, 'E mban derën hapur për... ndikimin serb' theksohej shumë më shpesh nga respondentët serbë se shqiptarë.

Tani, vazhdojmë me të anketuarit të cilët ishin 'aspak të kënaqur' ose 'shumë pak të kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Këta të anketuar u pyetën paralelisht në seri të ndryshme të pyetjeve pasuese. Mbani në mend se shumica e mostrave shqiptare (90%) dhe serbe (73%) ishin të pakënaqur me status kuo-në dhe prandaj iu nënshtruan pyetjeve vijuese:




Siç mund të shihet, të anketuarit shqiptarë kishin më shumë gjasë të përmendnin mungesën e lëvizjeve konkrete drejt integritimit evropian si arsye për pakënaqësi, të ndjekur afër nga mungesa e njohjes globale, mungesa e prosperitetit ekonomik, mungesa e zgjidhjes së problemeve të brendshme në mes të dy shteteve, dhe mungesa e njohjes nga Serbia. Të anketuarit serbë kishin prioritete të ndryshme, sidomos duke u fokusuar në prosperitetin ekonomik dhe në problemet e brendshme të pazgjidhura ndërmjet komuniteteve.

Sa i përket skenarit për status kuo, ne kemi parashtruar pyetjen shtesë: A do ta përkrahnit vazhdimin e status kuo-së për pesë vitet e ardhshme? Sikurse ekziston pakënaqësi me status kuo-në aktuale ndërmjet të anketuarve, poashtu ekziston 'aspak' (70%) dhe 'shumë pak' (10%) përkrahje për vazhdimin e status kuo-së për pesë vitet e ardhshme. Analiza e kryqëzuar tabelare tregon se respondentët (75%) që deklaruan 'aspak' ose 'shumë pak' përkrahje për status kuo-në aktuale deklaruan 'aspak' ose 'shumë pak' përkrahje për vazhdimin e status kuo-së për pesë vitet e ardhshme.




Sidoqoftë, vlerësimi i përgjigjeve të mostrës shqiptare dhe serbe tregon një model shumë të ndryshëm të përgjigjeve. 16% nga mostra shqiptare dhe 55% nga mostra serbe deklaruan 'disi' ose 'shumë' në përkrahje të vazhimit të status quo-së për pesë vitet e ardhshme. 83% të respondentëve shqiptarë krahasuar me 40% serbë deklaruan 'aspak' ose 'shumë pak' përkrahje për vazhdimin e status quo-së për pesë vitet e ardhshme. Përsëri, kjo është në pajtim me gjetjet për përkrahje të status quo-së: respondentët shqiptarë nuk janë aspak të kënaqur me status quo-në dhe nuk dëshirojnë që kjo të vazhdon.




### 3.3.2. Skenari i dytë: Njohja de facto nga Serbia, dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës

Lidhur me këtë skenar, pjesëmarrësve iu parashtrua pyetja vijuese: A pajtoheni me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia? Rreth (15%) e pjesëmarrësve u deklaruan me 'fuqishëm pajtohem' ose 'disi pajtohem' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia. Shumica e pjesëmarrësve (81%) pohuan se 'disi nuk pajtohen' ose 'aspak nuk pajtohen' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia.




Analiza e përgjigjeve në mesin e mostrës shqiptare dhe serbe tregon modele shumë të kundërta të përgjigjeve. 11% në mesin e shqiptarëve krahasuar me 51% serbë deklaruan se 'plotësisht pajtohem' ose 'disi pajtohem' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia. Përkundrazi, 87% në mesin e shqiptarëve krahasuar me 26% në mesin e serbëve

deklaruan me 'disi nuk pajtohem' ose 'plotësisht nuk pajtohem'. 2% në mesin e shqiptarëve dhe 24% në mesin e serbëve u deklaruan me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




Me një numër pyetjesh pasuese, sondazhi kërkoi të kuptonte arsyet kryesore për të cilat të anketuarit pajtoheshin apo nuk pajtoheshin me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia. Të anketuarit që u shprehen me 'plotësisht pajtohem' ose 'disi pajtohem' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, iu parashtruan pyetjet në vijim (mbani në mend, 11% e mostrës shqiptare dhe 51% e asaj serbe iu parashtruan këto pyetje):





Në mesin e të anketuarve serbë që iu parashtruan këto pyetje pasuese, arsyeja më e shpeshtë ishte ajo 'do t'u japë serbëve ... më shumë zë në procesin e vendimmarrjes' ndjekur nga 'do të përmirësoj integrimin e komunitetit serb në Kosovë' ndërsa respondentët shqiptarë, arsyeja më e shpeshtë ishte 'do të përmirësoj prosperitetin ekonomik në Kosovë'.

Duke u kthyer prapa tek të anketuarit që u shprehen me 'plotësisht nuk pajtohem' ose 'disi nuk pajtohem' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, një seri tjetër e pyetjeve pasuese u parashtruan (mbani në mend, 87% e mostrës shqiptare dhe 26% e mostrës serbe iu parashtruan këto pyetje, prandaj numri i respondentëve serbë në këto pyetje është shumë i vogël):




Siç mund të shihet, të anketuarit shqiptarë të cilët e kundërshtuan dhënien e kompetencave ekzekutive të AKS-së, u pajtuan plotësisht se kompetencat e tilla mund të hapin derën për krijimin e një mini Republika Srpska, pasuar nga shqetësimet lidhur me ndarjen e komuniteteve në Kosovë dhe rritjen e tensioneve politike në mes Kosovës dhe Serbisë.

### 3.3.3. Skenari i tretë: Korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës, dhe hapjes së rrugës për anëtarësim në OKB


Përderisa ky skenar është parashtruar, të anketuarit u pyetën me pyetjen vijuese: Nëse korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultonte në njohje globale të Kosovës dhe do të hapte rrugën për anëtarësim në OKB, a duhet Kosova të mbështesë një marrëveshje të tillë për të korrigjuar kufijtë? 30% e mostrës u deklaruan se Kosova 'definitivisht duhet' ose 'ndoshta duhet' të mbështesë opsionin e korrigjimit të kufirit (shih grafikun mëposhtë). Anasjelltas, 64% deklaruan se Kosova 'ndoshta nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të mbështesë opsionin e korrigjimit të kufirit. 5% deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.

Nëse korrighimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapte rrugë për anëtarësim në OKB, a duhet Kosova të mbështesë një marrëveshje të tillë për të korrighuar kufijtë?




Analiza e veçantë e mostrës shqiptare dhe serbe paraqet një model të ndryshëm të përgjigjeve me një mbështetje disi më të madhe për këtë skenar nga respondentët serbë. Pra, 29% në mesin e shqiptarëve dhe 40% në mesin e serbëve u shprehen se Kosova 'definitivisht duhet' ose 'ndoshta duhet' të mbështesë skenarin e korrighimit të kufirit nëse do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapte rrugë për anëtarësim në OKB. Ndryshe, 67% në mesin e shqiptarëve dhe 39% në mesin e serbëve u shprehen se Kosova 'ndoshta nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të mbështesë skenarin e korrighimit të kufirit. 4% në mesin e shqiptarëve dhe 22% në mesin e serbëve deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.

Nëse korrighimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapte rrugë për anëtarësim në OKB, a duhet Kosova të mbështesë një marrëveshje të tillë për të korrighuar kufinjte?




#### 4. A mendoni se qeveritë e Kosovës dhe Serbisë duhet të bëjnë përpjekje maksimale për arritje të një marrëveshje përfundimtare?

Për më shumë se një vjet, dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është ndërprerë bazuar në tarifën 100% të qeverisë së Kosovës ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës. Komuniteti ndërkombëtar ka ushtruar presion për heqjen e tarifës ashtu që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të vazhdon dhe të arrihet një marrëveshje përfundimtare. Akterët politikë në pozitë dhe opozitë mbasin të ndarë nëse Kosova duhet të bëjë përpjekje intensive në arritjen e një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Në mesin e opinionit publik – zëri i popullit – gjetjet tona tregojnë se 89% mendojnë se qeveritë e Kosovës dhe Serbisë ‘definitivisht duhet’ ose ‘ndoshta duhet’ të bëjnë çdo përpjekje për arritje të një marrëveshje përfundimtare. Vetëm 9% deklaruan se qeveritë e Kosovës dhe Serbisë ‘ndoshta nuk duhet’ ose ‘definitivisht nuk duhet’ të bëjnë çdo përpjekje për arritje të një marrëveshje përfundimtare dhe vetëm 2% deklaruan se ‘nuk e di/nuk kam ndonjë mendim’ për këtë çështje. Ky, prandaj, është një mesazh i qartë nga publiku për udhëheqësit politik.



Sidoqoftë, vlerësimi i përgjigjeve ndërmjet mostrave shqiptare dhe serbe tregon një model të ndryshëm të përgjigjeve. 92% në mesin e shqiptarëve dhe 64% në mesin e serbëve deklaruan se qeveritë e Kosovës dhe Serbisë ‘definitivisht duhet’

ose 'ndoshta duhet' të bëjnë çdo përpjekje për arritje të një marrëveshje përfundimtare. 7% në mesin e shqiptarëve dhe 22% në mesin e serbëve deklaruan se qeveritë e Kosovës dhe Serbisë 'ndoshta nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të bëjnë çdo përpjekje për arritje të një marrëveshjeje përfundimtare. 1% në mesin e shqiptarëve dhe 15% në mesin e serbëve deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje. Analiza e kryqëzuar tabelare tregon se respondentët shqiptarë (66%) dhe serbë (49%) që mbështesin rifillimin e dialogut, tregojnë mbështetje edhe për qeverinë e Kosovës dhe Serbisë për të bërë përpjekje për arritje të një marrëveshje përfundimtare.



## 5. Struktura e qëndrimeve

Është me interes të konsiderueshëm që të gjurmohet struktura e qëndrimeve të respondentëve ndaj temave të ndryshme të përfshira në seksionet e mësipërme. A janë njerëzit konsistent në mbështetje ose kundër çështjeve si rifillimi i dialogut, korrigjimi i kufirit me qëllim të arritjes së marrëveshjes, dhe bashkimi eventual me Shqipërinë, apo ata i ndryshojnë opinionet nga tema në temë?

Ne mund të vlerësojmë raportet ndërmjet të gjitha matjeve – qëndrimet për rifillim të dialogut, përpjekja maksimale për përfundim të bisedimeve, vazhdimi i status kuo-së për pesë vitet e ardhshme, tre skenarët, dhe bashkimi me Shqipërinë në rast të arritjes së njohjes – për të cilat raportuam mësipër, duke zbatuar teknikat si analiza korrelacionale dhe faktoriale.

Në bazë të këtyre analizave, **modeli i parë** që vërejmë edhe pse duket qartë, nuk është befases: Respondentët që janë të pakënaqur me status kuo-në janë poashtu të pakënaqur me vazhdimin e status kuo-së për 5 vitet e ardhshme. Poashtu, mendojnë se qeveria duhet të rifilloj dialogun dhe të bëjë çdo përpjekje për gjetje të një zgjidhje. Në të kundërtën, respondentët që janë të kënaqur me status kuo-në poashtu janë të kënaqur me vazhdimin e saj për pesë vitet e ardhshme, nuk pajtohen me rifillimin e dialogut, dhe janë kundër përpjekjeve për gjetje të një zgjidhje. Këto katër qëndrime janë ngushtë të ndërlidhura, si në mbështetje ashtu edhe kundër. Me fjalë tjera, njohuria se si një respondentë mendon për një nga këto tema është një udhëzues i mirë edhe për tri temat tjera në këto kategori. Ekziston një konsistencë e konsiderueshme në qëndrimet e njerëzve në këto katër çështje specifike.

**Modeli i dytë** që është për qëndrimet lidhur me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për AKS, dhe korrigjimin e kufirit me qëllim të njohjes globale janë mjaft ngushtë të ndërlidhura. Megjithatë, qëndrimet ndaj çështjeve në këtë kategori nuk janë aspak të ndërlidhura me qëndrimet në modelin e parë. Me fjalë tjera, njohuria se ndonjë nuk pajtohet me status kuo-në ose pajtohet me rifillimin e dialogut nuk është indikator i mirë se çfarë janë qëndrimet e tij për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për AKS, ose korrigjimin e kufinjve. Kjo do të thotë se njerëzit që janë në mbështetje të rifillimit të dialogut kanë mendime të ndryshme sa i përket koncesioneve, nëse ndonjë, do të duhet të bëhet/lejohe në proces të dialogut. Rrjedhimisht, njerëzit mund të pajtohen mbi nevojën e rifillimit të dialogut por të mos pajtohen mbi marrëveshjet që duhet të bëhen ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Vërehet që këto çështje, si AKS dhe korrigjimi i kufirit janë të gjitha për të cilët respondentët serbë tregojnë më shumë mbështetje se respondentët shqiptarë. Prandaj, siç u tregua më lartë, respondentët serbë janë disi më mbështetës për dhënien e kompetencave ekzekutive për AKS, dhe korrigjimin e kufinjve. Struktura e qëndrimeve është e njëjtë si për shqiptarët ashtu dhe serbët, me një model të ngjashëm në këto çështje në secilin komunitet. Në këtë kuptim, kjo

kategori e çështjeve mund të interpretohet edhe si tregues se sa bashkëpunues ose konfliktuozë janë njerëzit në prirjet/vizionet e tyre.

**Modeli i tretë**, ose më mirë mungesa e modelit ndërlidhës, është se qëndrimet për bashkimin me Shqipërinë janë të veçuara nga qëndrimet ndaj të gjitha çështjeve tjera. Bashkimi nuk është ngushtë i lidhur më asnjë nga këto çështje. Në një mënyrë tjetër, njerëzit që mbështesin bashkimin në mënyrë të barabartë mund të jenë të kënaqur apo të pakënaqur me status kuo-në, dhe në mbështetje ose kundër korigjimit të kufirit. Kjo është një çështje e ndarë që nuk ndërlidhet as me modelin e parë dhe as të dytë të çështjeve.

Tabela vijuese paraqet strukturën e qëndrimeve. Tregon se si modeli i parë i qëndrimeve është ngushtë i ndërlidhur me të quajturën si trendi për 'qasje për ndryshim' në opinionin publik, kurse modeli i dytë ndërlidhet ngushtë me të ashtuquajturën si trendi për 'bashkëpunim' ose 'përshtatje e dyanshme', derisa qëndrimet për bashkim janë pak a shumë të ndarë.<sup>10</sup>

	Qasje për ndryshim	Përshtatje e dyanshme	Bashkim
(Pa)Kënaqësia me status kuo	<b>0.75</b>	0.14	0.16
Gjetja e marrëveshjes	<b>0.75</b>	-0.05	0.03
(Mos)Vazhdimi i status kuo-së	<b>0.77</b>	0.19	0.00
Rifillimi i Dialogut	<b>0.68</b>	-0.10	-0.27
Kompetenca Ekzekutive për AKS	0.24	<b>0.70</b>	-0.02
Korigjimi i kufirit	0.02	<b>0.71</b>	-0.20
Bashkimi me Shqipërinë	0.04	-0.07	<b>0.90</b>

Në përgjithësi, analiza tregon për ndarje të qëndrimeve në dy modele. **Brenda** secilit model njerëzit tregojnë qëndrime konsistente, por është një tregim tjetër **ndërmjet** modeleve: njohuria se ku qëndron njëri në çështje brenda modelit të parë nuk është indikator i mirë se ku qëndron në çështje brenda modelit të dytë. Pra, njerëzit mund të pajtohen rreth nevojës për rifillim të dialogut dhe se duhet të bëjnë çdo përpjekje për gjetjen e zgjidhjes, por të mos pajtohen rreth marrëveshjes specifike që duhet të bëhen ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

<sup>10</sup> Tabela paraqet përcaktimet faktoriale të njësisive në bazë të analizës rotacionale faktoriale me tre faktorë.

## 6. Analiza Krahasuese

Në këtë seksion, ne i analizojmë të dhënat ndër-seksionale të përsëritura dhe krahasojmë disa nga pyetjet kryesore nga sondazhi i parë, i dytë dhe i tretë. Sondazhi i parë u realizua në dhjetor 2018, i dyti në maj 2019, dhe i tretë në fund janar 2020. Qëllimi i sondazhit të dytë dhe tretë ishte të hulumtonte më thellë skenarët e 'finaleve të mëdha' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sondazhi i dytë dhe i tretë ishin identikë dhe në shumë aspekte i ngjajnë sondazhit të parë, i cili ka metodologji të ngjashme, metodë për përzgjedhjen e komunave dhe përzgjedhje të mostrës (edhe pse nuk ka përfshirë nga respondentët përgjigjet për arsyt). Për të bërë krahasime janë bërë përshtatjet ndërmjet tri sondazheve sa i përket profileve të mostrave për moshë dhe gjini. Shihni mëposhtë disa nga pyetjet kryesore dhe analizat krahasuese:

### **a) Rifillimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?**


Që nga ndërprerja e dialogut për rreth një vjet, ne kemi ndryshuar paksa pyetjen krahasuar me sondazhin 1 dhe 2. Në dy sondazhet paraprake pyetja është shtruar: "A pajtoheni me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?" ndërsa në sondazhin e tretë pyetja është riformuluar si "A përkrahni rifillimin e dialogut ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe Serbisë?"

Me qëllim të krahasueshmërisë së këtyre pyetjeve në tri sondazhe, ne i shprehim këto në mënyrën nëse respondentët kanë qëndrime pozitive ose negative ndaj dialogut. (Pra, respondentët në dy sondazhet e kaluara që nuk kanë dashur të vazhdojnë me dialogun, dhe respondentët në sondazhin e tretë që nuk kanë dashur të rifilloj dialogu janë konsideruar me qëndrime negative.)

Në sondazhin e parë, mbi gjysma e respondentëve (62%) ishin pozitiv për dialogun dhe përkrahën vazhdimin e dialogut. Kjo përqindje ka pësuar rënie në sondazhin e dytë (në 50%), por në sondazhin e tretë një përqindje më e madhe (70%) shprehën qëndrime pozitive dhe përkrahën rifillimin e dialogut. Këto



trende në tri sondazhe ishin të ngjashme si në mostrat shqiptare ashtu dhe serbe. Diagrami paraqet trendet në tri sondazhe në mostrat shqiptare dhe serbe.




**b) A duhet Kosova të kërkojë bashkimin me Shqipërinë, nëse njihet nga Serbia?**

Gjetjet tregojnë se ekziston një mbështetje e paqëndrueshme në tri sondazhe sa i përket bashkimit me Shqipërinë. Me mbështetje prej 43% në sondazhin 1, mbështetja për bashkimin u ngrit në 53% në sondazhin 2, por pastaj ka rënie në 38% në sondazhin e tretë.<sup>11</sup> Vlerësimi i mëtejshëm tregon se mbështetja për bashkimin ka qenë vazhdimisht më e ultë në mostrat serbe se mostrat shqiptare, edhe pse trendet në kohë janë të ngjashme. Duhet të theksohet se në mostrën serbe ka një numër të madh të përgjigjeve me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje (18% në Sondazhin 1 – 24% në Sondazhin 2 – 43% në Sondazhin 3).

Ky ndryshim në kohë është statistikisht i rëndësishëm ( $p < 0.01$ ) dhe meqenëse pyetja është bërë në mënyrë identike në tri sondazhet, ne mund të kemi besim në rezultat. Megjithatë mbizotëron e vërteta se opinioni qëndron mjaft i ndarë në mes të bashkimit me Shqipërinë dhe ruajtjes së status quo-së mes dy shtetesh.


<sup>11</sup> Vëreni që dallimi ndërmjet diagramit dhe shifrave në tabelë i atribuohet pikëve dhjetore.

Barazpesha e opinionit është zhvendosur, por jo në mënyrë vendimtare. Paqëndrueshmëria e opinionit mund të reflektoj atë se bashkimi mbetet çështje hipotetike aktualisht, prandaj, njerëzit nuk kanë krijuar mendim definitiv për këtë.




### **c) Tre skenarët alternativ për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë**

Sa i përket skenarit- **status kuo**- krahasimi i rezultateve tregon se ka një rritje në pakënaqësi me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nga sondazhi i parë në atë të dytë, dhe mbetet shumë e lartë në sondazhin e tretë (79% Sondazhi 1 - 89% në Sondazhin 2 - 86% në Sondazhin 3). Kjo rritje është vërejtur sidomos në mostrat shqiptare (82% Sondazhi 1 - 91% në Sondazhin 2 - 90% në Sondazhin 3), por ka një nivel më të ultë të pakënaqësisë, dhe paqëndrueshmëri më e madhe, në mostrat serbe (50% Sondazhi 1 - 70% në Sondazhin 2 - 44% në Sondazhin 3). Edhe një herë ndryshimet janë statistikisht të rëndësishme ( $p < 0.01$ ). Një interpretim i mundshëm i këtij konstatimi është se sa më gjatë vazhdon bllokimi me disa çështje që kanë mbetur të pazgjidhura, aq më i madh është zhgënjimi i popullsisë në mungesë të progresit. Shih grafikun mëposhtë për krahasimin e rezultateve në tri sondazhe.




Skenari- **dhënia e kompetencave ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia**– rezultatet e përgjithshme tregojnë se ekziston një kundërshtim i madh me mbi katër të pestat nga secila mostër për dhënien e kompetencave ekzekutive për këtë skenar (85% Sondazhi 1 - 86% Sondazhi 2 – 81% Sondazhi 3). Megjithatë, ekziston rezultate të ndryshme në mostrat shqiptare dhe serbe. Mostrat shqiptare tregojnë vazhdimisht kundërshtim të lartë për dhënien e kompetencave ekzekutive për AKS (87% në Sondazhin 1 – 92% në Sondazhin 2 – 87% në Sondazhin 3). Ndërsa, mostrat serbe tregojnë një rënie të rëndësishme në kundërshtim dhe rritje proporcionale në përkrahje të kompetencave ekzekutive për AKS. Përkrahja për propozimin është ngritur nga 17% në Sondazhin 1 në 48% në Sondazhin 2 dhe 49% në Sondazhin 3. Kjo do të thotë se ka pasur rritje në polarizim sa i përket këtij skenari ndërmjet komunitetit shqiptar dhe serb.

Ne duhet të kujtojmë se mostrat e të intervistuarve serbë janë mjaft të vogla (rreth 100 të anketuar në secilin nga tre sondazhet). Megjithatë, proporcioni në rritje i mostrave serbe në sondazhin e dytë dhe tretë që përkrahin kompetencat ekzekutive të zgjeruara për AKS është statistiki i rëndësishëm ( $p < 0.01$ ). Prandaj duket se ka vërtet një rritje në shtrirjen e polarizimit ndërmjet dy komuniteteve në këtë çështje. Kjo mund të reflektojë edhe një herë zhgënjimin në çështjet e pazgjidhura ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.



Skenari – **korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultojë në njohjen globale të Kosovës dhe do të hap rrugë për anëtarësim në OKB** – rezultatet e përgjithshme, që mbështesin këtë skenar mbeten relativisht të qëndrueshme (29% Sondazhi 1 - 32% Sondazhi 2 – 31% Sondazhi 3). Mbështetja në mesin e mostrës shqiptare është stabile (30% Sondazhi 1 - 32% Sondazhi 2 – 30% Sondazhi 3). Sidoqoftë, ekziston një rritje në mbështetje në mesin e serbëve (28% Sondazhi 1 - 33% Sondazhi 2 – 39% Sondazhi 3), edhe pse këto ndryshime janë në kufi të rëndësisë statistikore ( $p=0.04$ ). Duhet të theksohet se ka pasur një proporcion të konsiderueshëm në mostrat serbe (21% Sondazhi 3) që deklaruan 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



## 7. Përfundimet

Qëllimi i këtij sondazhi, sikurse i dy sondazheve të mëhershme, ishte të kuptoheshin perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve (*Zëri i Popullit*) në lidhje me skenarët për 'Finalen e Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Me një numër prej 1107 respondentëve në sondazhin tonë (90% shqiptarë, 8% serbë dhe 2% nga grupe të tjera etnike) kjo mostër paraqet përfaqësim kombëtar të popullsisë së Kosovës. Ky sondazhi i tretë mbajtur në fund të muajit janar 2020 përsërit shumë pyetje nga sondazhi i parë dhe i dytë të realizuara në dhjetor 2018 dhe maj 2019, respektivisht. Kështu na mundëson që të shqyrtojmë ndryshimet gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. Gjithashtu, sondazhi i tretë dhe i mëhershmi (sondazhi i dytë) shtoi disa pyetje të reja duke eksploruar më në thellësi arsyet e qytetarëve për preferencat e tyre.

Në disa aspekte, sondazhi i tanishëm përsërit dhe përforcon gjetjet nga sondazhi i parë dhe i dytë, si dhe ofron disa gjetje të reja. Në veçanti ne gjejmë se:

- Sikurse në sondazhin e parë dhe të dytë ekziston një mbështetje e fuqishme nga të dy komunitetet (mbështetje e fuqishme veçanërisht nga komuniteti shqiptar) për rifillimin e dialogut.

- Dy komunitetet (por sidomos komuniteti shqiptar) besojnë se qeveria duhet të bëjë çdo përpjekje për arritje të një marrëveshje përfundimtare – gjetje e re.
- Sikurse në sondazhin e parë dhe të dytë ekziston një pakënaqësi e konsiderueshme me status kuo-në përbrenda komunitetit shqiptar ndërsa komuniteti serb ka qëndrime më të përziera sa i përket vazhdimit të status kuo-së;
- Sikurse në sondazhin e parë dhe të dytë ka shumë pak mbështetje nga komuniteti shqiptar për dhënie të kompetencave të zgjeruara ekzekutive për AKS. Sidoqoftë, gjetje e re është se shumica e komunitetit serb tanimë mbështesin dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për AKS;
- Sikurse në sondazhin e parë dhe të dytë ekziston një mbështetje modeste në të dy komunitetet për korrigjimin e kufirit me Serbinë, me kusht që kjo të sjellë njohje globale, edhe pse përkrahësit për këtë skenar mbizotërohen nga ata që e kundërshtojnë.

Megjithatë, përderisa linjat e përgjithshme kanë ndryshuar paksa, ka një numër treguesish se çfarë mund të interpretohet si frustrim në rritje me mungesën e progresit në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Ka gjithashtu dëshmi shqetësuese për polarizim ndërmjet dy komuniteteve mbi kompetencat ekzekutive të AKS-së. Ekziston rreziku që dallimet ndërmjet dy komuniteteve do të bëhen edhe më të thella.

Duke u kthyer në pyetjet pasuese për të cilat u pyetën të anketuarit rreth arsyeve të tyre, rezultatet mbesin të ngjashme me gjetjet nga sondazhi i dytë. Si në sondazhin e dytë, ne kemi gjetur dallime substanciale sa i përket arsyetimeve nga të dy komunitetet. Në rastin e *skenarit të parë*, pakënaqësi me status kuo-në, respondentët shqiptarë kishin më shumë gjasa të përmendnin mungesën e lëvizjeve konkrete drejt integritimit evropian si arsye për pakënaqësinë e tyre (85%). Kjo pasohej nga afër me mungesën e njohjes globale (75%), mungesën e prosperitetit ekonomik (62%), mungesën e zgjidhjes së problemeve të brendshme ndërmjet dy komuniteteve (60%), dhe mungesën e marrëdhënieve paqësore me Serbinë (57%). Përkundrazi, respondentët serbë kishin prioritete të ndryshme

duke u fokusuar në problemet e brendshme të pazgjidhura (50%) dhe mungesa e marrëdhënieve paqësore me Serbinë (23%).

Në rastin e *skenarit të dytë*, dhënia e kompetencave ekzekutive të AKS-së, respondentët serbë që ishin në favor të skenarit ishin veçanërisht të prirur për të dhënë si arsye të tyre 'më shumë zë në procesin e vendimmarrjes' (68%). Arsye tjera të shpeshta të theksuara nga serbët, edhe pse më pak, kishte të bënte me integrimin e komunitetit serb në Kosovë (49%) dhe përmirësimin e marrëdhënieve me Serbinë (34%).

Respondentët shqiptarë që kanë kundërshtuar dhënien e kompetencave ekzekutive të AKS-së, u fokusuan në arsye të ndryshme. Ata/o u pajtuan fuqishëm që kompetenca të tilla mund të hapnin derën për krijimin e një mini Republika Srpska (86%). Kjo u ndoq afër nga shqetësimet lidhur me forcimin e ndarjeve mes komuniteteve në Kosovë (84%) dhe rrezikun e rritjes së tensioneve politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (79%).

Në rastin e *skenarit të tretë*, korrigjimi i kufirit në këmbim të njohjes globale, ka një mbështetje prej (30%) nga komuniteti shqiptar dhe më shumë nga komuniteti serb (40%). Vihet re se mbështetja për këtë skenar nuk ka ndryshuar substancialisht në mesin e shqiptarëve, por është rritur substancialisht në mesin e serbëve.

Në përgjithësi, perspektivat e të dy komuniteteve vazhdojnë të ndryshojnë krejtësisht në disa aspekte: të anketuarit serbë treguan shqetësim të veçantë për çështjet e brendshme që prekin komunitetin serb në Kosovë. Përkundrazi, respondentët shqiptarë ishin të shqetësuar më shumë për çështjet e jashtme si integrimin në BE dhe njohjen globale, edhe pse ata shqetësoheshin edhe për rrezikun e krijimit të një mini Republika Srpska. Megjithatë, këto perspektiva të ndryshme nuk përjashtojnë marrëveshjen. Integrimi në BE nuk ngërthen në vete ndonjë zgjidhje specifike për çështjet e brendshme në Kosovë. Sfida është të ofrohen zgjidhje që përmbushin objektivat e të dy komuniteteve.

Për fund, një aspekt vital i gjetjeve të reja është krahasimi ndërmjet mbështetjes së fuqishme për arritjen e marrëveshjes dhe mungesa e mbështetjes së fuqishme për tri skenarët e trajtuara në këtë raport. Kjo vërehet sidomos në mesin e komunitetit shqiptar të cilët janë shumë të pakënaqur me status kuo-në, por nuk pajtohen edhe aq me ndonjërin prej skenarëve të trajtuar.

Një analizë më e hollësishme tregon se qëndrimet e qytetarëve për status kuo-në, rifillimin e dialogut dhe gjetjen e një zgjidhje janë mjaft konsistente. Njerëzit që nuk janë të kënaqur me situatën aktuale poashtu dëshirojnë rifillimin e dialogut, dhe dëshirojnë që qeveria/institucionet të bëjnë çdo përpjekje në arritjen e një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Ky është *Zëri i Popullit* nga komuniteti shqiptar. Në mënyrë të qartë, komuniteti shqiptar flet për ndryshim.

Përkundrazi, si nga komuniteti shqiptar ashtu edhe ai serb nuk ekziston një mesazh i qartë nga njerëzit se si të arrijnë ndryshimin. Në një kuptim, njëri mund të pyes se pse ekziston kjo rrugë qorre – sipas perceptimeve të opinionit publik secili nga tre skenarët ka dobësi të ndjeshme. Por, në të njëjtën kohë, kjo nuk e përjashton mundësinë e mbështetjes së publikut për një marrëveshje të ndërmjetësuar nga SHBA dhe Evropa. Duke pasur parasysh interesimin/etjen e publikut për përfundim të kësaj rruge qorre dhe sigurimin e njohjes ndërkombëtare dhe integrimin Evropian, mbështetja e publikut mund të gjenerohet me arritjen e një marrëveshje që përmbush këto tre qëllime. Një marrëveshje që arrin këto tre qëllime, që për të gjitha ekziston një mbështetje e gjerë publike, mund të jetë e suksesshme.



